



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës
Opština Priština –Municipality of Prishtina

Në bazë të dispozitave të nenit 12, paragrafi 12.2, pika d dhe nenit 14, paragrafi 1 i Ligjit nr. 03/L - 040, për vetëqeverisje lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", nr. 28/15, qershor 2008), nenit 10, paragrafi 1.6 të Ligjit nr. 04/L-144, për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", nr. 35/17 dhjetor 2012), nenit 20, paragrafi 2 të Rregullores QRK, nr. 23/2013, për përcaktimin e procedurave për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës, dhe të nenit 33.2, shkronja a, dhe nenit 34.1 shkronja d të Statutit të Komunës së Prishtinës, 01. nr. 110-391, të dt. 25.02.2010, Kuvendi i Komunës së Prishtinës, në mbledhjen e mbajtur më 25.07.2017, merr këtë

V E N D I M

- I. **MIRATOHET** propozimi i Kryetarit të Komunës për dhënien e pronës së paluajtshme të Komunës në shfrytëzim afatgjatë Fondacionit për mbrojtjen e kafshëve "Vier Pforten" e përfaqësuar nga kryetari i fondacionit, z. Helmut Dungler, pa procedurë konkurrimi.
- II. Prona e paluajtshme e dhënë në shfrytëzim, e cekur në pikën I, gjendet në pjesën kadastrale nr. 32, 33 dhe 36, Zona kadastrale Novo Sellë, me sipërfaqe të përgjithshme 157677 m².
- III. Afati kohor për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme komunale, të përshkruar në pikën II të këtij vendimi, është afatgjatë për 99 vjet.
- IV. Prona e paluajtshme komunale e përshkruar në pikën II të këtij vendimi, jepet në shfrytëzim pa kompensim.
- V. Mënyra dhe kushtet e shfrytëzimit të pronës së paluajtshme do të përcaktohen me kontratë, e cila lidhet dhe nënshkruhet në mes të Kryetarit të Komunës dhe përfaqësuesit të shfrytëzuesit.
- VI. Prona e paluajtshme komunale që jepet në shfrytëzim, e përshkruar në pikën II të këtij vendimi, duhet të evidentohet në librat kadastralë të Komunës.
- VII. Për zbatimin e këtij vendimi kujdesen: Kryetari i Komunës, Drejtorja e Pronës dhe Drejtorja e Kadastrit e Komunës së Prishtinës.

VIII. Pjesë përbërëse e këtij propozimvendimi janë:

- skicat grafike,
- kopjet e planit dhe certifikatat e pronësisë.

IX. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, shfuqizohet Vendimi nr. 01. nr. 031 - 20133, dt. 31.05.2012, për caktimin e lokacionit për ndërtimin e strehimorese së arinjve dhe shtazëve të tjera të egra dhe anulohet kontrata e mëhershme nr. 01-46-36102, të datës 03.10.2012, e lidhur ndërmjet Komunës së Prishtinës dhe Fondacionit për mbrojtjen e kafshëve "Vier Pfoten".

X. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e Komunës.

KUVENDI I KOMUNËS SË PRISHTINËS

01. nr. 463/01-0182407, më 26.07.2017.



KRYESUESI I KUVENDIT
Halim Halimi, jur. i dpl.